



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
Kuvendi – Skupština - Assembly

Legjislatura III

Seanca e Kuvendit të Kosovës

S- 004

Prishtinë, më 15 shkurt 2008, në orën 20:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare

PROCESVERBAL

NGA SEANCA E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 15 SHKURT 2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 85 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët me rendin e ditës për këtë seancë.

Kuvendi njëzëri miratoi këtë

R e n d i t e:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008
2. Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Projektbuxhetin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2008

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me Raportin dhe rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008.

Ai i hodhi në votim, një nga një, amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008 me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----73,
Kundër-----13,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet Ligji nr. 03/L013 për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar -31 dhjetor 2008.
2. Totali i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008, është në shumë prej 1.114,81 miliardë eurosh.
3. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që t'i inkorporojë amendamentet në tekstin përfundimtar të ligjit.

2. Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Projektbuxhetin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2008

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektbuxhetin e Zyrës së Rregullatorit të Energji dhe për Autoritetin Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2008

Kryetari i hodhi në votim rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----64
Kundër-----13
Abstenime----- 7

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash mori këto

V E N D I M E:

I.

1. Miratohet Buxheti i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin fiskal 2008.

2. Buxheti i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin fiskal 2008, është si në vijim:

- paga dhe mëditje në shumë prej 314.420 euro,
- pagesat për punë jashtë orarit, shtesat dhe stimulimet në shumë prej 86.625 euro,
- mallra dhe shërbime në shumë prej 604.000 euro,
- shpenzimet kapitale në shumë prej 40.000 euro,
- shpenzime komunale në shumë prej 17.500 euro,

Gjithsej shpenzimet për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë për vitin fiskal 2008, janë në shumë prej 1.062.545 eurosh.

3. Buxheti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin fiskal 2008, inkorporohet në tabelat buxhetore të Ligjit nr. 03/L-013 për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar -31 dhjetor 2008.

II.

1. Miratohet Buxheti i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin fiskal 2008.

2. Buxheti i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin fiskal 2008, është si, në vijim:

- paga dhe mëditje në shumë prej 222.279,40 euro,
- mallra dhe shërbime në shumë prej 408.000 euro,
- shpenzime komunale në shumë prej 12.300 euro,
- shpenzimet kapitale në shumën prej 1.600.000 euro,

Gjithsej shpenzimet për Autoritetin Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin fiskal 2008, janë në shumën prej 2.242.579,40 eurosh.

3. Buxheti i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin fiskal 2008, inkorporohet në tabelat buxhetore të Ligjit nr. 03/L-013 për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar -31 dhjetor 2008.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 21:05minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Jakup KRASNIQI

E hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale